



PUNIME DHE PROJEKTIME TOPOGJEODEZIKE

Adresa: Rr. "Kongresi i Lushnjes"

Tel: +355 4 222 5072

E-mail ggeo_vjosa@yahoo.com

RILEVIME TOPOGRAFIKE

PROJEKTIME TOPOGJEODEZIKE PER VEPRA

TE INFRASTRUKTURES

HARTA KADASTRALE

HARTA TEMATIKE

PLANIMETRI OBJEKTESH

FOTOGRAMETRI

Punimet topografike per projektin e rruges automobilistike u kryen mbi bazen e kerkesave teknike te per gjithshme, te kerkesave specifike te parashtuara nga perfaqesuesi i firmes projektuese, si dhe mbi bazen e perves se perfshuar ne punimet e meparshme te kesaj natyre.

Me marrjen e porosise, firma "Gjeo – Vjosa" shpk kreu menjehere punimet per gatitore, sigurimin e hartave dhe te koordinatave te pikave mbeshtetese gjeodezike per zonen ku shtrihet rruga. U krye pernjohja e terrenit, qe sherbeu per percaktimin e sakte te metodikes dhe organizimit te punes dhe per menyren e ndertimit te rrjetit gjeodezik te rilevimit. Po ashtu, ne terren na u dhane udhezime plotesuese dhe specifike nga perfaqesuesi i firmes projektuese, ku u sqarua me mire aksi ku parashikohet ndretimi i rruges dhe gjeresia e saj, qe kerkonte nje rilevim aksial me gjeresi 100 deri 120 metra. Per kryerjen e punimeve gjeodezike dhe te rilevimit topografik te brezit te rruges, Firma "Gjeo – Vjosa" krijoji grupin e punes te perbere nga inxhinieret gjeoded Perparim Likaj, Qemal Sinanaj dhe specialistet Erdit Salillari, Fatos Ahmeti, Endrit Kercani, Fatjon Rabija, Aurel Kalaj, Evrion Haderi, Sokol Cullhaj etj.

Pernjohja e terrenit, ndertimi, matja dhe llogaritja e rrjetit gjeodezik.

Fillimisht u krye pernjohja e terrenit, duke kryer dhe vleresimet perkatese mbi bazen e te cilave u percaktua metodika dhe organizimi per kryerjen e punimeve topografike dhe gjeodezike ne terren.Terreni ku do te ndertohet rruga eshte teresisht fushor, pa disnivele te ndjeshem. Ne pjesen e pare te saj, ne nje gjatesi rreth 1 km, ajo kalon ne qender te banuar, mbi aksin e nje rruge ekzistuese, por te ngushte dhe me shtepi banimi ne te dy anet. Pjesa tjeter e rruges kalon ne fushen ish kenetore te Durrësit. Kjo pjese eshte e cveshur nga ndertimet, por jane te pranishem rrjeti i kanaleve kullues dhe vadites, si dhe disa rruge, qe lidhin zonat rurale ne perendim dhe lindje te fushes. Ne pjesen e pare te rruges kerkohet kujdes i vecante per rilevimin e qendres se banuar me te gjithe objektet e saj, ne pjesen fushore kerkohet kujdes i vecante per paraqitjen e sakte vecanerisht te kanaleve kullues qe kane gjeresi deri ne 10 – 15 metra dhe thellesi 3-4metra,qe kerkojne trajtim te hollesishem per projektimin e urave tombinove,per veshjet anesore etj. Poashtu, kryqezimet e trasese se rruges se re me rruget ekzistuese kerkojne punime topografike me te detajuara, me te sakte dhe me gjeresi me te madhe.

Per kryerjen e sakte te punimeve topografike ne sherbim te projektimit te rruges u krye fillimisht ndertimi i rrjetit gjeodezik mbeshtetes per rilevimin. Per zhvillimin e rrjetit gjeodezik kryem kerkimin dhe zbulimin e pikave mbeshtetese gjeodezike te rrjetit shteteror, por ne afersi te zones u gjeten vetem dy pika me koordinata shteterore te rrjeteve dendesues, si dhe pika e fanarit te Durrësit, te cilat ishin te mjaftueshme per lidhjen e punimeve topogeodezike te projektit te rruges me rrjetin shteteror te koordinatave. Vlere te vecante pati gjetja e dy markave te Nivelacionit Shteteror, njera ne Shkozet dhe tjetra ne Hidrovorin e Durrësit, pra afersisht ne ekstremet e rruges.Keto dy marka jane mbeshtetja me e sigure per punimet naltimetrike te projektimit dhe zbatimit te punimeve ne rruge ,prandaj dhe poligonometrine naltimetrike e lidhem me keto dy

pika shteterore te saktesise se larte. Shpeshtimi i rrjetit gjeodezik u krye me metoden e poligonometrise me dy rende. Rendi i pare perbehet nga poligonometria kryesore, qe siguron mbeshtetjen dhe lidhjen e punimeve me rrjetin shteteror. Fiksimi i pikave ne terren u krye me kunja hekuri me gjatesi 40-50 cm, te vendosur ne vende te qendrueshme, prane rruges, duke siguruar ne kete menyre lidhjen dhe vazhdimesine e punes nga faza e projektimit ne ate te zbatimit te punimeve.

Rendi i dyte perbehet nga poligonet e rilevimit , te mbeshtetur ne poligonometrine kryesore dhe shtrihen per gjate gjithe brezit te rruges.Jane fiksuar ne terren 15 pika te poligonometrise kryesore, kurse dendesimi i metejshem midis pikave kryesore eshte kryer gjate procesit te rilevimit, por me fiksim te perkohshem.Bashkelidhur ne kete material jepet dhe lista e koordinatave dhe lartesive te pikave te poligonometrise kryesore dhe fotot e tyre.

Matjet gjatesore dhe kendore te poligonometrise u kryen me Stacion Total te tipit Leica 307, qe ploteson te gjitha kerkesat teknike te rrjetit te rilevimit, si ne planimetri, ashtu dhe ne naltimetri.Matjet kendore u kryen me tre seri, kurse matjet gjatesore te poligonometrise u kryen vajtje - ardhje per te siguruar saktesine e nevojshme dhe kontrollin e tyre. Duke patur parasysh vecantite e terrenit, qe, kryesisht eshte fushor dhe pjesa me e madhe e fushes ndodhet nen nivelin e detit, gjykuam se paraqitja ne naltimetri e cdo objekti te terrenit duhet te kete saktesi te larte, prandaj, per kete arsy, zhvilluam poligonin me nivelim gjometrik te mbeshtetur ne te dy market e lartepermendura te nivelacionit shteteror. Per kontroll nivelimi u zhvillua me dy horizonte instrumenti per cdo stacion.Gjatesia e poligonit te nivelimit gjometrik eshte afersisht 10 km, kurse gabimi ne mosmbylljen e poligoni nuk duhet te kaloje vleren qe jep formula:

$$Wh = \pm 30\sqrt{L} = \pm 30\sqrt{10} = 30 \times 3.16 = 95 \text{ m/m.}$$

Wh faktike rezulton 45 m/m pra matjet e nivelimit gjeometrik jane te nje sakte te kenaqeshme.

Rilevimi i brezit te rruges

Duke u mbeshtetur ne pikat e poligonometrise u zhvillua rrjeti i rilevimit te brezit te rruges. Rilevimi u krye kryesisht mbi baze te profilit gjatesor dhe te profilave terthore, por duke marre dhe pika detaje plotesuese midis tyre per te kriuar modelimin e sakte te reliefit per gjate gjithe brezit. Ne percaktimin e profilave terthore jemi bazuar kryesisht ne kushtet e terrenit dhe ne perputhje me kerkesat e per gjithshme teknike te hartimit te projektit. Ne sektoret drejtevizore te rruges eshte ruajtur largesia jo me e madhe se 15 metra midis profilave terthore. Gjeresia e rilevimit eshte 100 deri 130 metra. Ne kryqezimet e trasese se rruges me rruget ekzistuese dhe kanalet e gjere kullues, si dhe ne vendet e kthesave eshte kryer rilevim i detajuar dhe me gjeresi me te madhe se e zakonshmja. Jane kryer matje plotesuese ne te gjitha tombinot dhe urat. Kanalet jane rilevuar sipas profilit te tyre te plote dmth jane marre pika ne te dy buzet e skarpatave, dy pika per gjeresine e shtratit te tij, si dhe ne rruget dhe argjinaturat anesore. . Ne rruget ekzistuese jane marre pika ne aks, ne te dy anet e saj, ne bankinat dhe ne kanalet anesore . Jane marre gjithashtu te gjithe linjat elektrike dhe telefonike qe kryqezohen me trasene e rruges si dhe ne afersi te saj.

Gjatesia e per gjithshme e trasese se rilevuar per te dy variantet arrin 10 km. Numri i per gjithshem i profilave terthore eshte 818, pra i takon qe te jetë matur mesatarisht një profil ne 12 metra.

Numri i per gjithshem i pikave detaje per te gjithe trasene eshte afersisht 15700 , qe i takojne afersisht 1570 pika per nje km.

Ne zonat me ndertimene kilometrin e pare eshte kryer rilevimi i plete; jane hedhur te gjithe objektet urbane si ndertesat, muret rethues, sheshet ,etj. Per muret anesore prites dhe mbajtes jane matur dhe lartesite e tyre. Vemendje e vecante eshte treguar per hyrjet neper banesat, klubet, linjat e tensionit, kabinet elektrike, vendet me pjesesi te madhe, sheshet etj. Ne cdo rast jane rilevuan daljet e rrugeve te tjera nga rruga kryesore, me qellim qe te parashikohen mire nga projektuesit kerkesat per tombino, per kanale te devijimit te ujrave, apo te ndonje vepre tjeter ne funksion te kryqezimit te rrugeve dhe te hyrjeve ne oborret private.

Rilevimi eshte kryer gjithashtu me Stacion Total, keshtu qe per pikat konturore dhe relievin e terrenit realizohet saktesi e larte.

Duke u mbeshtetur ne shkallen e plete te perqatitjes profesionale,ne perdorimin e teknologjive bashkekohore per matjet fushore dhe perpunimin kompjuterik te te dhenave, ne seriozitetin dhe perjegjesine per te plotesuar kerkesat teknike te parashtruara nga projektuesit, shprehim bindjen se punimet topogeodezike plotesojne te gjitha kerkesat teknike per projektimin e rruges.Rrjeti gjeodezik ne formen e poligonometrise sherben dhe per zbatimin e punimeve.

SHTOJCA A

H

AF-InfraTransProject sh.p.k



Fotot e shenjave per piketim





Per “Gjeo – Vjosa “ sh.p.k.

Administratori

Dr.Inxh. Perparim Likaj

AF-InfraTransProject sh.p.k

